

STATUTI I SHOOËRISË dhe AKT THEMELIMI

“ISTANBUL CARE AGENCY” SHPK

Sot me date 01.09.2022, ne perputhje me:

- Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare";
- Ligjin nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"

Z. UEJD DEDAJ ,shtetas Shqipetar, i lindur me 12.08.1992 ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbajtes i Karte Identiteti me ID J20812050P themelon ne cilesine e Ortakut te Vetem, Shoqerine me perjegjesi te kufizuar
“ISTANBUL CARE AGENCY” SHPK me permajtjen si me poshte vijon:

KAPITULLI I FORMA; KOHËZGJATJA; ZYRA QENDRORE; OBJEKTI

Neni 1: Forma Juridike

Shoqeria **“ISTANBUL CARE AGENCY” SHPK** eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoheri me perjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”), e themeluar nga personi fizik i siperpermendur, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara

Neni 2: Kohezgjatja

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.


Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pakufizuar qe fillon prej dates se regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, pranë Qendren Kombetare te Biznesit (me poshte referuar si QKB).

Në përputhje më këtë statut, shoqëria mund të pezulloje ose mbyllë veprimtarinë e saj kur e sheh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

Neni 3: Zyra Qendrore

Zyra Qendrore e Shoqerise ndodhet ne adresen: **Rruga e Kavajes pasuria me numer 6/10 +6 -60 volumi 5. Zona kadastarle 8380 Tirane**

Gjate ushtrimit aktivitetit te saj, shoqeria mund te hape dege ose zyra perfaqesimi si brenda dhe jashtë territorit te Republikes se Shqiperise.



Neni 4: Objekti

Shoqeria do te kete per objekt kryesor te veprimtarise se saj:

- a) sherbime te ndryshme
- b) asistence per kompani te huaja per turizem shendetesor
- c) agjensi nderlidhese
- d) asistence permes sherbimit telefonik
- e) konsulence informative
- f) sherbime per reklama
- g) marketing
- h) asistence per sherbime te ndryshme

-Gjithashtu, per te realizuar objektivat e saj, shoqeria mund te ndermarre e te zhvilloje edhe cdo lloj aktiviteti tjeter te ligjshem ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe qe siguron te ardhura dhe fitime te ligjshme.

- Objekti i shoqerise mund te zgjerohet apo zvogelohet ne varesi te interesave te shoqerise dhe ne baze te vendimit te asamblese se per gjithshme te ortakeve.

KAPITULLI II **KAPITALI**

Neni 5 : Kapitali themeltar

5.1. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 300000 lekë i formuar ne mase te plote nga kontributi i ortakut dhe i ndare ne nje kuote me vlere nominale sipas ndarjes se me poshtme. Cdo kuote njesie ka te drejten e nje vote. Pjesmarja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tij si me poshte:

Ortaku themelues Uejd Dedaj, zoterues i nje kuote me vlere te per gjithshme 300000 (treqind mijë) leke, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

KAPITULLI III **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

Neni 6

Organet kryesore drejtuese te shoqerise jane:

- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve
- Administratori

Neni 7 **Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve** **Te drejtat dhe detyrimet**

Uejd Dedaj 

7.1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne ligj.

7.2. Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji

7.3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtronë nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilat nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 8

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Përgjithshme se Ortakeve

8.1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë drejtuar ortakeve te shoqerise. Njoftimi me shkresë duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

8.2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 10.1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 9 Kuormi

- a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- b) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht dhe votojnë me shkresë.
- c) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 10 Marria e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 11 Administrimi

11.1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, te cilet duhet te jene detyrimisht ortake te saj. Afati i emërit të administratorit eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit

11.2. Administrator i pare i shoqerise eshte Z. Uejd Dedaj I cili zgjidhet per nje periudhe 5 vjecare.

11.3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratoret në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Neni 12



Kompetencat e administratoreve

Administratoret kane të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmes shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përrpara asamblesë së përgjithshme përmiratim; krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përrpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmes veprimtarinës së shoqërisë tregtare;
- f) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut

Neni 13

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per do mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor nen juridikcionin e se cilit shtrihet aktiviteti i shoqerise.

Neni 14

Largimi i ortakut

Ky statut nuk mund te perashtoje apo te kufizoje te drejten e ortakut per t'u larguar nga shoqeria dhe te drejten e shoqerise per te perjashtuar ortakun ne baze te dispozitave perkatese te legjislacionit tregtar ne fuqi.

Neni 15

Dispozita perfundimtore

Ne cdo rast, palet do ti referohen dispozitave ligjore te ligjit 9901, date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" per zgjidhen e cesh eve konkrete dhe te detajuara te cilat nuk jane permendur specifisht ne kete akt themelimi personi juridik.

Ky statut u hartua ne 3 ekzemlare me permbajtje dhe vlera te njejtajuridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi u miratua ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i Vetem i Shoqerise, u nenshknia rregullisht nga ai pa asnje verejtje.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Uejd Dedaj

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Uejd Dedaj".